



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-081

Prishtinë, më 29 tetor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 29 TETOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Safete Hadërgjonaj, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Burim Ramadani, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Gjithashtu, kryesuesi i njoftoi të pranishmit se kryetari i Kuvendit gjendet për vizitë zyrtare në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22 tetor 2012,
2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

* * *

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 22 tetor 2012

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 22 tetor 2012.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia e shqyrtoi propozimin e rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme, për secilën pikë veç e veç. Për propozimin e pikës së 6-të pati propozime se duhet zhvilluar debat parlamentar pas informimit të Kuvendit nga kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e zhvilluar në Bruksel me kryeministrin e Serbisë.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 1 nëntor 2012, me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
4. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv,
5. Votimi i Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar,
6. Informimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e zhvilluar në Bruksel me kryeministrin e Serbisë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë,

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e duhanit,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e pagesave,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonat ekonomike
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme,
13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës,
14. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e tre anëtarëve në Bordin për Ankesa të Medieve,
15. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave:

1. Kërkesa e Kryeministrit të Kosovës për ta informuar Kuvendin e Kosovës për takimin e tij me kryeministrin e Serbisë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, e radhiti atë për mbledhjen plenare më 1 nëntor 2012.

2. Kërkesa e deputetit Ramë Vataj, mbështetur edhe nga tetëmbëdhjetë deputetë të tjerë, për debat parlamentar lidhur me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Kryesia e shtyu procedimin e kërkesës së deputetit Ramë Vataj për mbledhjen e radhës.

3. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi për formimin e Komisionit të lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare që deri në seancën e radhës, më 1 nëntor 2012, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

2. Përbërja e Komisionit duhet të jetë: GP i PDK-së 2 anëtarë, GP i LDK-së 2 anëtarë, GP VV 1 anëtar, GP i AAK-së 1 anëtar, GP i KKR-së 1 anëtar, GP i SLS-së 1 anëtar dhe GP 6+ 1 anëtar.

4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit të deputetëve në Bruksel

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i katër deputetëve të Kuvendit dhe të dy zyrtarëve të Administratës së Kuvendit që të marrin pjesë në Seminarin Parlamentar, me temën “Mbrotjtja e të drejtave të njeriut dhe situata e grave dhe fëmijëve”, që do të mbahet në Bruksel, prej 13-16 nëntor 2012.
2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës, me mundësi të rimbursimit nga Parlamenti Evropian.

5. Kërkesa e kryetarit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media Idriz Vehapi, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Egjipt

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i kryetarit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, z. Idriz Vehapi, që, në kuadër të delegacionit të Ministrisë së Kulturës, të marrë pjesë në vizitën zyrtare në Egjipt, prej 10 deri më 14 nëntor 2012.
2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartpërmendurin në paragrafin 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

6. Kërkesa për mbulimin e disa shpenzimeve për Delegacionin e Parlamentit Evropian që do ta vizitojë Kosovën

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet mbulimi i shpenzimeve për dy dreka pune, që do t’i shtrojnë përfaqësuesit e Kuvendit të Kosovës me rastin e vizitës së raportuesit të Këshillit të Evropës për situatën në Kosovë, z. Bjorn Von Sidov, si dhe për delegacionin e Parlamentit Evropian, që do ta vizitojë Republikën e Kosovës më 30 dhe 31 tetor 2012.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:05 minuta.

Nënkryetari i Kuvendit

Xhavit HALITI